

EDON QESARI

**NJË LÉGION ÉTRANGÈRE MES SHQIPTARËSH:
HISTORIA E BATALIONIT “ANTONIO GRAMSCI”
(1943-1944)**

Abstrakt:

Studimi mëton një vëzhgim linear të ecurisë historike, përgjatë viteve 1943-1944, të njësisë partizane me emrin “Antonio Gramsci” në Shqipërinë e Luftës II Botërore. Synohet kësisoj, përpos renditjes tekstuale të fakteve të grumbulluara përmes dokumentacionit, të jepet edhe një kuadër më i gjerë shpjegues i zhvillimeve dhe i njeve politike rrethanore që çuan në formimin, e mandej shfrytëzimin sa ideologjik aq dhe teknik-ushtarak, të pranisë së një grushti nënoficerësh italianë në një luftë të huaj për ata vetë. Një pikë shumë e rëndësishme në këtë çështje, e që merr në studim një vëmendje të veçantë, është orvatja e partizanëve shqiptarë për t’i dhënë vlerë ideologjike “konvertimit” të italianëve, nga pjesëtarë të një ushtrie që përftohet si pushtuese (pos të qenit fashiste) në vijues të një “internacionalizmi” antifashist. E nevojshme në këtë drejtim duket se ishte vetë edukimi antifashist i këtyre trupave të rishta, operacion jo fort i lehtë e që i shtohet barrës që kishin italianët, të cilët, edhe për sa i përket përgatitjes teknike, u gjendën shpesh në skenarë të paparashikueshëm për ta, të pastërvitur siç ishin me një luftë thelbësisht guerile.

Fjalë kyçe:

Lufta II Botërore, Batalioni “Antonio Gramsci”, Mehmet Shehu, ideologjizimi, LANÇ.

“Kjo lufta jonë e mballosur që, si fillim, kishte nisur pikërisht kur ishte marrë vendimi për ta përmbyllur, shfaqej tamam si një përleshje të mjerësh; por, që të jemi të qartë, jo “mjeranësh”, të tillë siç kishim qenë përherë ne, ushtarët italianë, që në atë rrethanë nuk do të ish pak; jo, kjo ishte një betejë njerëzish edhe më të mjerë e fatkeqë. Dhe siç dihet, të mjerëve u bie barra më e rëndë.”¹

“Biro, i thoni atij që mos i përziej këta me të tjerët! Se i kemi qarë me ligje si djemtë tanë.”²

Sipas disa përlloraritjeve, duhet të ketë qenë rreth 25 000 numri i trupave ushtarake italiane të cilat, të mbërthyera nga ngjarjet që ndoqën shpalljen e armëpushimit mes Romës dhe anglo-amerikanëve (8 shtator 1943), u përfshinë, në mënyrë aktive apo pasive, në qëndresën antinaziste në Shqipëri përgjatë viteve 1943-1944.³ Nga të gjitha divizionet italiane të pranishme në territorin shqiptar, vetëm “Firenze” dhe “Perugia” ngritën krye ndaj trupave të Berlinit pas marrjes nën arrest, nga ana e gjermanëve, të gjeneralit Ezio Rossi, kryekomandant i Grupit të Armatave Lindore (*Gruppo delle Armate dell’Est*). Kësisoj, duke shtuar raste të përveçme, vlerësohet se ishte rreth 2 000 numri fillestar i

* Ky punim vjen në vazhden e kumtesave të mbajtura, në trajtë më të përmbledhur, në dy konferenca shkencore në Romë dhe në Bari – përkatësisht në “Fondazione Antonio Gramsci onlus”, më 2017, e në Universitetin “Aldo Moro”, më 2019 – mbi pjesëmarrjen e ushtarëve italianë në Luftën Antifashiste në Shqipëri.

¹ Viscardo Azzi, *I disobbedienti della 9^a Armata, 1943-1945*, Milano: Mursia, 2010, f. 27. [Fragmentet e cituara në këtë punim janë përkthyer prej meje – E.Q.]

² Është thirrja që një grua e moshuar i bën tërthorazi protagonistit në filmin shqiptar “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1989, regjia: Dhimitër Anagnosti), i cili ka ardhur në Shqipëri për të tërhequr eshtrat e ushtarëve italianë të rënë gjatë luftës. Skena lë të kuptohet se gjenerali në fjalë ka gjetur varre të italianëve që luftuan krah partizanëve shqiptarë, të varrosur në të njëjtin truall me shqiptarë, e jo në varreza të zakonshme ushtarësh të huaj. Në këtë mënyrë, përcillet narrativa zyrtare e regjimit komunist në Shqipëri, që theksonte dallimin mes dashamirësisë popullore ndaj këtyre italianëve - të gjykuar si “tanët” dhe pothuajse të shkëputur nga trangu i tyre etno-kombëtar, e jo më kot “të qarë” pas zakonit - me pjesën e mbetur të bashkëkombësve të tyre, të mbetur “të huaj” në sytë e popullatës civile.

³ Massimo Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani all’estero. L’Albania*, Ministero della Difesa, Commissione per lo studio della Resistenza dei militari italiani all’estero dopo l’8 settembre 1943, Roma: 1999, f. 681, 697.

ushtarakëve italianë që nuk i dorëzuan armët *Wermacht-it*⁴, duke iu kundërvënë trupave gjermane që u zunë vendin fill pas kapitullimit të Romës.⁵ Pjesa tjetër mundën të vinin në zbatim njëfarëlloj qëndrese pasive, duke zgjedhur të mos rreshtoheshin me aleatët e vjetër të Italisë dhe duke mos përfillur trysninë gjermane për t’iu bashkuar vullnetarisht *Wermacht-it*, e as për të dorëzuar armatimet siç u kishte kërkuar edhe vetë gjenerali Lorenzo Dalmazzo, në këmbim të kthimit të pashqetësuar në Itali.⁶

Veçanërisht për ata që vendosën të kundërvepronin ndaj gjermanëve, gjendja do të rrëshqiste shpejt në *impasse*; nisur nga vetë nevoja për një marrëveshje me lëvizjen antinaziste vendase, në sytë e së cilës italianët ruanin ende statusin e trupave pushtuese. Paqartësia e rrethanave dhe vetë pamundësia për të manovruar në një terren politikisht të paqëndrueshëm, shprehen më mirë me fjalët e një nëntogeri, i quajtur Oriano Dalla

⁴ Arbëreshi Vittorio Mattanà, radiotelegrafist i divizionit “Perugia”, me vendqëndrim në Gjirokastër, dëshmon në ditarin e tij kërkesën që iu bë nga kreu i një milicie të lidhur me Ballin Kombëtar, ditën e 8 shtatorit 1943, fill pas shpalljes së armëpushimit italian: “A mund t’i thuash ti zotërinjve oficerë që janë këtu të pranishëm se, tashmë që Italia firmosi armëpushimin ju do të niseni mirë e bukur për në vendin tuaj, sakaq që na bie ne dhe shokëve gjermanë që të vazhdojmë të luftojmë komunistët?”. Vittorio Mattanà, *Un arbëresh in Albania nella Seconda Guerra Mondiale. Diario di un soldato telegrafista, 1940-1945*, Cosenza: Edizioni Orizzonti Meridionali, 1997, f. 71.

⁵ Divizioni “Perugia” has në një fat tragjik në vijim të qëndresës së vet ndaj trupave gjermane dhe atyre vendase (hamendësohet nacionaliste). Për më shumë, shih: Antonio Giuseppe Dore, “Le vicende della divisione “Perugia” in Albania dopo l’8 settembre 1943”, in *Lotta armata e Resistenza delle forze armate italiane all’estero* (a cura di Biagio Dradi Maraldi e Romano Pieri), Milano: F. Angeli, 1990, f. 188-205.

⁶ Mario Fantacci, “Un italiano in Albania” (I), në *Il movimento di liberazione in Italia*, a cura dell’Istituto nazionale per la Storia del Movimento di Liberazione in Italia, nr. 40, Milano: gennaio 1956, f. 37; shih gjithashtu: Viscardo Azzi, *Il prezzo dell’onore: Albania 1943-’44*, Milano: Mursia, 2009, f. 119; Luigi Amati, “Quasi totale il crollo delle armate in Albania”, në *Patria indipendente*, (XXVII), Roma: 10 settembre 1978, nr. 14. Për një pasqyrë më të përgjithshme të qëndresës antinaziste të italianëve në Shqipëri, shih veçanërisht: Elena Aga Rossi, *Una guerra a parte. I militari italiani nei Balcani 1940-1945*, Bologna: Il Mulino, 2011, *passim*; Alberto Becherelli, Andrea Carteny, Fabrizio Giardini, *L’Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-2012)*, Roma: Edizioni Nuova Cultura, 2013, f. 229; Alfonso Bartolini, *Per la patria e la libertà!* Milano: Mursia, 1986, *passim*; Ilio Muraca, “Quando soldati ed ufficiali scelsero di battersi per la libertà”, në *Patria Indipendente*, Roma: aprile 2010, f. 36-37.

Chiesa, që paraqesin rrokopujën në të cilën gëlonte gjendja shpirtërore e trupave italiane në ato ditë.

“Të shkoje pas gjermanëve (aleatë madhorë deri dje) donte të thoshte të ishte tradhëtar ndaj Mbretit. Të shkoje pas Aleatëve ishte e pamundur (pse pastaj, me këtë mik të ri që kishte shkatërruar qytetet tona, shtëpitë tona, të mirat tona, me bombardime pa mëshirë? veç ata mund të na sundonin?). Të tradhëtosh, nderin tënd e humbet kështu njëherë e mirë para popujve. Të shkoje pas partizanëve, ndërkaq që ishin shumë në numër dhe të paorganizuar, donte të thoshte se do të merrnim fund. Pa folur pastaj për përvojën e deri pak kohe më parë me ta, e cila më kishte brengosur.”⁷

Kjo dëshmi hedh dritë mbi “drojën fillestare të të gjithë oficerëve, si dhe ushtarakëve të marrë veçmas, për t’iu bashkuar partizanëve, kundër të cilëve kishin luftuar deri atë ditë”⁸. Ishin të parashikueshme pra, përplasjet e mundshme mes dy palëve që udhëhiqnin, secila për hesapin e vet, aksione të izoluara ndaj trupave gjermane. Për më tepër, shqiptarët “fajësuan italianët në lidhje me kryerjen e lloj-lloj shpërdorimi dhe krimi të kryer përpara armëpushimit. Për këtë shkak, thanë, do të duhej të na ndëshkonin, porse duke marrë parasysh se tashmë nuk ishim më armiq, ishin fare mirë të gatshëm të na falnin”⁹.

Kësodore, pas një takimi të parë, të ndodhur më 11 shtator, midis palëve në Burrel, u hodh në letër një marrëveshje e firmosur nga Haxhi Lleshi, kreu i misionit britanik Hands dhe nga gjenerali Arnaldo Azzi, në cilësinë e komandantit të trupave të “pabindura” [*disobbedienti*] italiane.¹⁰ Një komunikatë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë u jepte urdhër të gjithë vartësve të vet të pezullonin çfarëdolloj veprimtarie luftarake përkundrejt divizionit “Firenze”. Disa ditë më vonë, më 28 shtator, u organizua edhe takimi mes Azzi-t, Enver Hoxhës dhe krerëve

⁷ Cituar në M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 686.

⁸ Nga raporti i përpiluar prej nënkolonelit Goffredo Zignani, në adresë të gjeneralit Arnaldo Azzi, komandant i divizionit “Firenze”, cituar në V. Azzi, *I disobbedienti della 9a Armata...*, f. 34-55.

⁹ M. Fantacci, “Un italiano in Albania...”, f. 39.

¹⁰ Bruno Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà. Gli italiani della Divisione partigiana “Antonio Gramsci nella lotta di liberazione del popolo albanese*, Istituto Storico della Resistenza in Provincia di Lucca, Lucca: 1989, f. 17. Nisma për marrëveshjen, sqaron Brunetti, erdhi nga pala shqiptare.

të tjerë të qëndresës antinaziste shqiptare¹¹, në vijim të të cilit u lidhën marrëveshje të rëndësishme të karakterit ushtarak dhe politik që parashikonin shndërrimin e “Firenze”-s (sakaq të fuqizuar nga përfshirja në të të elementëve të tjerë të mbërritur nga divizionet “Brennero” dhe “Arezzo”) në njësi të mëvetësishme antigjermane. Vetë Azzi, që nuk kishte pranuar të dorëzonte armatimet as te gjermanët dhe as te partizanët e Haxhi Lleshit, u vu në drejtimin e Komandës Ushtarake të Trupave në Mal (CMTM - Comando Militare Truppe alla Montagna).¹²

1. Në këtë mënyrë, mori trajtë një çmprehje në marrëdhëniet midis ushtarëve italianë dhe popullatës civile, arritje e cila e pati burimin, siç dëshmohet, tek ndërmjetësimi i partizanëve shqiptarë.¹³ Ishin këta që duket se përdorën dallimin figurativ midis pushtuesit dhe ndihmuesit – të dy italianë, por i pari fashist, ndërsa i dyti pjesë e një shtresëzimi popullor – për të ushqyer afrimin e këtyre ushtarëve me vatrat civile ku mund të gjenin strehim të përkohshëm.¹⁴ Kështu, sakaq që prototipi i shqiptarit, në përfytyrimin kolektiv të ushtarëve italianë, kapërcen shëmbëlltyrën e banditit dhe merr trajtat e bashkëpunëtorit/shpëtimtarit¹⁵ – a të paktën të ndihmësit për t’i mbijetuar rrokopujës pas kapitullimit – një evolucion të ngjashëm pëson edhe *esprit* i trupave përkundrejt ndodhive të luftës.

Sidoqoftë, për vetë italianët, çështja që lypte zgjidhje të menjëhershme kishte të bënte me mënyrën e përfshirjes së tyre në luftën ndaj gjermanëve: nëse do të angazhoheshin përkrah Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por duke ruajtur të drejtën për nisma autonome përmes CMTM-së; apo do t’i bashkoheshin drejtpërdrejt radhëve

¹¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH) / Arkivi i Partisë së Punës për periudhën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Fondi (më tej: F.) 14, Viti (më tej: V.) 1943, Dosja (më tej: D.) 29, fl. 3, datë 28 shtator 1943.

¹² A. Becherelli, A. Carteny, F. Giardini, *L’Albania indipendente ...*, f. 229; Franco Benanti, *La guerra più lunga: Albania 1943-’48*, Milano: Mursia, 1966, f. 107.

¹³ M. Fantacci, “Un italiano in Albania...”, f. 48-49.

¹⁴ “Fashizmi ju ka ngarkuar me një njollë. Ju takon ta hiqni” – thuhet të ketë deklaruar Mehmet Shehu, në një prej takimeve të para me krerët e ushtarëve italianë, siç dëshmon një reportazh i organit “Giornale del Mattino”, që botohej enkas, fill pas çlirimit, për ushtarët italianë të përfshirë në brigadat e LANÇ-it. Shkrimi është i pranishëm në katalogun e digjitalizuar të Biblioteca Nazionale Centrale, të Romës. (/giornali/002696738_1945_03/BNCR_002696738_1945_003_057_001.jpg).

¹⁵ “Nga malet zbresin partizanë! Partizanë? Ushtarët ishin mësuar të dëgjonin të flitej për kryengritës, për banditë, por kurrë për partizanë; emërtesë që tingëllonte krejt e re për të gjithë ata”. B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 17.

partizane, duke pësuar njëkohësisht hegjemoninë politike të shqiptarëve.¹⁶ Luhatja nuk mund të ishte e paparashikueshme. Megjithëqë, siç pohon Rochat, kalimi në bashkëpunim me komunistët, që gjykoheshin si elementë të së vetmes qëndresë reale dhe serioze ndaj gjermanëve, nuk ishte sigurisht rrjedhojë e një qasjeje ideologjike. Të paktën në ndërgjegjen politike të krerëve ushtarakë italianë, që pak apo aspak kishin ç'të ndanin me bindjet komuniste, njerëzit e Hoxhës gëzonin mbështetje në popullatë.¹⁷ Nga ana e vet, kjo e fundit mund të kishte sjellje dashamirëse, por ajo mund të merrte edhe trajta jo fort të pëlqyeshme - që nga mospërfillja ndaj kërkesave për strehim dhe ushqim, e deri te denoncimi pranë autoriteteve gjermane. Andaj, të rrije në krahun e partizanëve, përbënte një detyrim të mirëfilltë për të qenë së paku të pranuar dhe të strehuar mes njerëzish fort të vetëdijshëm për gjendjen e nderë të ushtarëve italianë, të braktisur siç qenë nga shtatmadhoritë e tyre dhe të pamundur për të siguruar një riatdhesim pa pasoja në Itali, që ishte dhe gjithë ç'mund të shpresohej në ato kushte të vështira luftime.¹⁸ E ndonëse bëhej fjalë për një numër aspak të vogël ushtarësh, që në pjesën e tyre dërrmuese nuk kishin ndonjë lidhje me boshtin ideologjik të komunistëve shqiptarë¹⁹, nevoja për mbijetesë i jep shpjegim, të paktën pjesërisht, prirjes së disa italianëve për të lënë rangjet e tyre (përfshirë ato të CMTM-së) e për t'iu bashkuar drejtpërdrejt Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

¹⁶ Mundësi, të dyja, të cilat ishin shpallur nga vetë Enver Hoxha të nesërmen e bërjes së qartë të vullnetit për të bashkëpunuar nga ana e palëve. *AQSH*, F. 14, V. 1943, D. 3, fl. 47, 15 shtator 1943.

¹⁷ Giorgio Rochat, *Prefazione* në V. Mattanà, *Un arbëresh in Albania...*, f. 9.

¹⁸ Sipas kreut të Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri, gjeneralit Dawies, ushtarët italianë nuk ishin vërtet të tërhequr nga mundësia e përfshirjes në veprimtaritë luftarake. Vetë partizanët shqiptarë nuk shfaqën ndonjë interesim të mirëfilltë ndaj keqtrajtimit të italianëve ("s'i vinte dot faj kush"), duke pasur si qëllim vetëm përvetësimin e armëve, veshmbathjeve dhe të tjera të mira materiale që ata zotëronin. Edmund "Trotzki" Dawies, *Illyrian venture*, London: Garen City, 1952, f. 86.

¹⁹ Coltrinari, nga ana e vet, këmbëngul në tezën e mospërputhjes mes formimit politik të ushtarëve italianë dhe ideologjisë së partizanëve shqiptarë (M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 678). Megjithëse, që në vjeshtën e vitit 1941, konsulli gjerman në Tiranë pohonte se qendra e përhapjes së ideve komuniste në Shqipëri gjendej në gjirin e pranisë ushtarake italiane në vend. Kështu sipas dokumentacionit gjerman (*Captured German Records* (më tej CGR), që përmban dokumente të Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme dhe të Komandës së Lartë të *Wermacht*-it, të cilat gjenden pranë *National Archives* në Uashington, SHBA) të cituar nga Bernd Fischer në *Shqipëria gjatë Luftës, 1939-1945*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 179.

Për më tepër terreni ishte mjaftueshëm pjellor për qëllimet e propagandës dhe politikës rekrutuese të komunistëve shqiptarë, të cilët ushtruan shumë trysni me synimin për të rritur kontrollin mbi ushtarët italianë, duke ndërhyrë jo rrallëherë në çështjet e brendshme të CMTM-së. Kjo veprimtari e tyre nuk u kundërshtua kurrë në mënyrë të hapur pasi, edhe nëse do të bëhej mund të vihej në rrezik bashkëpunimi ndaj armikut të përbashkët. Përpos, miklimet komuniste i hapën shtegun rreshtimit të disa italianëve, kryesisht nënoficerë - jo vetëm të atyre të strehuar në popullatë, por edhe mes trupave të Azzi-t - “në njësi me tipare dhe emblema tërësisht partizane”.²⁰

Megjithatë, as kjo formë përshtatjeje nuk rezultoi fort e lehtë. Duke qenë se narrativa zyrtare kishte pësuar një goditje të rëndë pas 8 shtatorit 1943, e ushtria italiane nuk mund të ushqejë më me propagandë heroike para një realiteti të mjerë, “ruajtja e autoritetit dhe hierarkisë” ishte bërë thuajse e pamundur.²¹ Lufta partizane ishte diçka krejt e ndryshme krahasuar me gjithë veprimtarinë e zhvilluar deri në atë çast nga ana e çdo ushtari italian. E përqendruar në papritshmëri dhe në aksione sabotuese, në lëvizje të vazhdueshme dhe të pashoqëruara me mbështetje në prapavijë, në krijimin e rasteve për sulm të ndërmarrë nga njësite pak ose aspak të pajisura – porse të afta për të zënë në befasi dhe për të shpëtuar paq – guerilja përbënte një mënyrë të luftuari krejt të re për trupat italiane.²² Në mos për të tjerat, këto metoda të reja në angazhimin luftarak i shtynin italianët drejt një rrjeti të ri marrëdhëniesh hierarkike dhe disiplinimi të brendshëm. Pa përmendur pastaj *habitat*-in malësor, me të cilin ushtarakët e divizioneve italiane ishin të shtrënguar të bënin hesapet, që veç i detyronte t’i përshtateshin “mënyrave të një lufte jo më pozicionimi apo sulmi ballor, por përleshje të mbështetura më së shumti në të papritura dhe befasi, në sulme me qëllime të rreme (*a falso scopo*), bastisje të rrufeshme, të udhëhequra nga njësi të vogla luftëtarësh mbi troje të përshtatshme dhe të shqyrtuara paraprakisht përmes inspektimesh të posaçme”.²³ E gjithë kjo ndodhte në rrethana ku, siç nënvizon Chabod, guerilja antinaziste kryhej nga vullnetarë me uniformë.²⁴

²⁰ M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani ...*, f. 751-752, 881.

²¹ V. Azzi, *I disobbedienti della 9a Armata...*, f. 82.

²² Gianni Tartaro, “La piccola e fiera Albania teatro di aspra guerriglia”, në *Patria indipendente*, (XXXIII), Roma: 30 dicembre 1984, n. 21-23.

²³ B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 29.

²⁴ Federico Chabod, *L’Italia contemporanea (1918-1948)*, Torino: Einaudi, 1961, f. 131.

2. Merrte jetë në këtë mënyrë figura e partizanit italian, pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në qëndresën antinaziste shqiptare, i cili dallohej ndjeshëm nga ushtarët italianë që luftonin po kundër nazistëve por në një front tjetër, nën emblemën e CMTM-së. Kjo ndarje e italianëve në dy tipologji, që do të vazhdonte edhe pas luftës, shërbeu edhe si zgjidhje për të arritur atë ndikim që, qoftë për arsye të thjeshtë numri, njerëzit e Hoxhës e kishin të pamundur të ushtronin mbi trupat nën urdhrat e Azzi-t. Synimi i kësaj lëvizjeje bartte me vete edhe atë metamorfozë, ideologjikisht të rëndësishme për komunistët shqiptarë, që nxiste ushtarët italianë jo vetëm të shihnin nën një tjetër prizëm marrëdhëniet me rrënjësit, por edhe me veten, duke lënë përfundimisht pas uniformën, rangjet, e madje – në vazhden e njëfarë internacionalizmi të papërpunuar mirë teorikisht – identitetin kombëtar, për t’u bashkuar me popullin, me të shtypurin e deri me të huajin e kahershëm dhe bashkëpartizanin e sotëm.²⁵

Pos aspektit të mirëfilltë ushtarak, lypsej të shkohej më tej, pasi identiteti i këtyre rekrutëve rishtarë në batalionet shqiptare – tashmë partizanë si gjithë të tjerët, e jo më ushtarë italianë – duhej të pajisej edhe me një *credo* politike. Këtij qëllimi i shërbente formula organizative, e cila mëtonte njëfarëlloj *camaraderie* mes të huajsh, duke pleksur kësisoj guerilas dhe ushtarë, italianë e shqiptarë, që deri dje kishin luftuar mes tyre por që tashmë gjendeshin të bashkuar nga prejardhja sociale dhe synimi i përbashkët për të luftuar të njëjtin armik.²⁶

Nyja kryesore e kësaj linje propaganduese ishte identiteti klasor i shumë prej ushtarëve italianë, zakonisht me origjinë nga shtresat proletare apo rurale të jugut të Italisë, në kushte shoqërore të ngjashme me ato në të cilat lëngonte popullsia shqiptare. Pra, viktima bashkërisht të fashizmit, që italianët e përunjur i shfrytëzonte, ndërsa shqiptarët e varfër

²⁵ *AQSH*, F. 14, V. 1943 D. 145, fl. 1-2 (dokumenti nuk ka datë).

²⁶ Në vijim të operacionit të parë të përbashkët mes njerëzve të Lleshit dhe atyre të Azzi-t, në Krujë më 22-24 shtator 1943, Mehmet Shehu dokumentohet të ketë theksuar se qenia “punëtorë e fshatarë” e italianëve hiqte çfarëdolloj mërie nga ana e popullatës shqiptare kundrejt së shkuarës së tyre si ushtarë të një vendi pushtues. Sakaq, në të njëjtin dokument, vetë Shehu dëshmohet të ketë përjashtuar çfarëdolloj përgjegjësie që trupat italiane të kenë pasur në lidhje me gjakderdhjet fashiste të shkaktuara në Shqipëri, duke e përcjellë fajin te këmishat e zeza dhe te milicët e tjera (te njësia ushtarake e *Arditi*-ve në veçanti) të pranishme në vend. *AQSH*, F. 177, V. 1943, D. 2, fl. 10 (dokumenti nuk përmban datë por veçse një shënim të përgjithshëm “1943-1944”).

i pushtonte. Në këtë pikë, trumbetonte retorika zyrtare e LANÇ-it drejtuar ushtarëve italianë që konsideroheshin vullnetmirë për t'iu bashkuar partizanëve, “[p]opulli shqiptar, i drejtuar nga partia komuniste, ka bërë një ndarje të prerë mes fashizmit dhe bijëve të popullit punëtor, siç jeni ju”²⁷, duke shprehur kësisoj edhe një kritikë gjithëpërfshirëse, sipas Coltrinari-t, ndaj gjithçkaje që përfaqësonte identiteti kombëtar italian.²⁸ E një theksim i tillë veç paralajmëronte gjithë narrativën e mëvonshme, edhe pas çlirimit të vendit dhe vendosjes së regjimit socialist, të ligjërimit kundërshtar ndaj çdo elementi të huaj.²⁹

Një vëngëri e këtillë shfaqet qartë edhe në thirrjen që Ushtria Nacionalçlirimtare i drejton italianëve, ushtarakë ose jo, pak ditë pas kapitullimit të 8 shtatorit:

“U jemi drejtuar zyrtarisht Komandave tuaja ushtarake, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre. Pjesa dërrmuese e tyre, me përjashtim të fare pak rasteve, na janë përgjigjur në mënyrë të vagullt; kur ne u kemi kërkuar armë dhe municione, na janë përgjigjur me refuzim; kur jemi rrekur t’i përvetësojmë ato armë, kanë hapur zjarr mbi ne. Ka pasur shumë raste pastaj, gjë shumë e rëndë kjo, kur kishim arritur një marrëveshje dhe kur mbërriti çasti i dorëzimit, kanë hapur zjarr pabesisht. Pas nesh, erdhën gjermanët të cilët morën gjithçka nga krerët tuaj të shtirur dhe të shitur. Një ushtar gjerman i vetëm çarmatosi pesëdhjetë oficerë italianë rrugëve të Tiranës. Kapitullim më i turpshëm nuk mund të ndodhte. Të tillë tradhti vetëm fashistët mund ta shkaktonin. Nëse

²⁷ B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 28-29.

²⁸ M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 896. Për autorin një qëndrim i tillë buronte edhe nga politika e komunistëve jugosllavë, në orbitën e së cilës gravitonte komanda e ushtrisë partizane shqiptare. Vetë ky autor, gjithsesi, pranon se në Jugosllavi, formacionet homologe të CMTM-së, pra jokomuniste dhe madje as të lidhura me Komandën titiste, të tilla si brigada "Italia" dhe divizioni "Garibaldi", qenë organizuar në mënyrë që t’i shërbenin luftës partizane (*po aty*, f. 895, 897).

²⁹ “Ne dëshirojmë të çlirojmë Shqipërinë me forcat tona, por e duam edhe ndihmën e Aleatëve në armë dhe mjete, sepse e dimë shumë mirë që kur i huaji, edhe nëse është një aleat, pushton territorin tonë, duhet mund për ta shpënë përsëri atje nga erdhi! Në çdo rast, një pushtim aleat pa dyshim do ta drejtojë vendin drejt formave politike në kundërshtim me ato për të cilat luftojnë forcat partizane”, dëshmon Fantacci t’i ketë thënë një komandant brigade partizane. Cituar në Mario Fantacci, “Un italiano in Albania” (III), në *Il movimento di liberazione in Italia*, a cura dell’Istituto nazionale per la Storia del Movimento di Liberazione in Italia, nr. 41, Milano: maggio 1956, f. 25.

bashkoheshit me ne fill pas thirrjes tonë, gjermanët e Hitlerit nuk do të kishin mundur ta shtrinin pushtimin e tyre mbi Shqipëri, duke ju çarmartosur dhe bërë gati për kampet e përqendrimit, për punë të detyruar dhe ç'është me e keqja, për luftën vllavrasëse në krah të qeverisë më qesharake që mund të gjendet, që është ajo fashiste italiane e sajuar në Berlin. Thuajse tërësia e komandave tuaja, të mësuara të shërbejnë kusarinë e fashizmit dhe të pasardhësit të tij Badoglio, ka tradhëtuar sërish Italinë; madje edhe kur kishte gjithë mundësinë për t'i bërë mirë."³⁰

E në këtë drejtim, mohimi i fashizmit si themel ideologjik, sadopak që ky mund të kishte gjetur përhapje reale ndër ushtarët italianë, ishte i pamjaftueshëm. Atë duhet ta shoqëronte, gjithashtu, kritika e atyre faktorëve politikë-ushtarakë, siç mund të ishte monarkia, e në veçanti hierarkitë ushtarake, që prej fashizmit ishin molepsur, e ishin shndërruar në zëdhënës të orvatjeve pushtuese të tij. Shkak për të cilin, partizanët italianë në Shqipëri, ndryshe nga bashkëkombësit e tyre të CMTM-së, lypsej t'i bashkoheshin qëndresës shqiptare duke përqafuar jo vetëm synimet çlirimtare në luftë ndaj gjermanëve, por edhe ideologjinë e re antifashiste – e gjykuar kjo e fundit si thelbësore për sa i përket shtresëzimit të tyre në radhët e shqiptarëve dhe mikpritjes nga ana e popullatës civile.³¹ Italianët mund të ishin bashkëluftëtarë të shqiptarëve, në sytë e propagandës së shpërndarë nga zëdhënësit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por kjo përpjekje i mbante ata mënjanë, të shfrytëzueshëm vetëm si pikë mbështetjeje dhe gjithsesi të huaj për terrenin dhe popullatën. Që të bëheshin shokë [*compagni*], ata duhej të linin pas gjithçka prej identitetit të tyre, duke u kthyer kësisoj në partizanë të një kauze krejt të re deri në atë çast, e cila nënkuptonte gjithashtu njësim me komunistët shqiptarë.

"Shndërrimi" partizan, pra, do të përfaqësonte për ushtarin italian në Shqipëri jo vetëm shëlbimin ideologjik nga vetja, si ish okupator, por edhe mundësinë për të dhënë kontributin e tij në betejën antifashiste deri ditën e çlirimit – ditë e cila, në përfytyrimin e trupave partizane mernte gjithashtu trajtën e llogaridhënies së ngarkuar për shumëkënd (përfshirë italianët si ish kolonizues). Kjo është gjithashtu lënda themelore që përbën raportin përshkrues që këta partizanë italianë bënë për

³⁰ AQSH, F. 14, V. 1943, D. 146, fletë pa numër dhe datë. Dokumenti është në italisht.

³¹ Alfonso Bartolini, *Per la Patria e la Libertà. I soldati italiani nella resistenza all'estero dopo l'8 settembre*, Milano: Mursia, 1986, f. 190, 197.

veprimtarinë e tyre në Shqipëri, pasi vendi ishte çliruar nga forcat gjermane.³² Njësitë e tyre gueril, në atë dokument, deklarohet si i përbërë nga

“bij të popullit të vërtetë italian - punëtorë dhe fshatarë; ai ndjek rrugën e drejtë të shënjuar nga ata që donin t'i jepnin mundësinë për të fshirë njollën e zezë të turpit që i ishte ngulitur për shkak të fashizmit. Gjendja shpirtërore e partizanëve italianë nuk ka asnjë lidhje me atë gjendje shpirtërore të kohës kur ata ishin ushtarë në radhët e ushtrisë së vjetër; ndërsa më përpara gjithçka bëhej kundër vullnetit të tyre dhe vetëm sepse kështu udhëzonte disiplina e hekurt; sot këta shokë të vetëdijshëm për misionin e tyre dinë të luftojnë për një luftë të drejtë dhe për lirinë e vërtetë të njerëzve, ata bëjnë të lumtur çdo sakrificë dhe asgjë nuk i demoralizon.”³³

3. Rrethana të tilla nxitën krijimin e batalionit të parë partizan të përbërë nga ish ushtarë italianë, më 9 tetor 1943, në zonën e lumit të Tiranës.³⁴ Pagëzohet me emrin e Antonio Gramsci-t nga vetë Mehmet

³² Raporti, në të cilin nuk kursehen elozhet për Shehun, ishte porositur nga komanda e Divizionit të Parë shqiptar, në strukturat e të cilit ishte integruar batalioni "Gramsci", më 10 nëntor 1944, disa ditë para sulmit përfundimtar mbi Tiranën që ende ndodhej në dorën e autoriteteve gjermane. Udhëzimet në këtë drejtim pasqyronin mënyrën në të cilën komunistët shqiptarë interpretuan përvojën e batalionit italian. Do të mbetet e tillë për shumë dekada pasi të ketë përfunduar lufta. "Ky raport duhet të ketë formën e një artikulli për gazetat (i cili gjithashtu mund të dërgohet në gazetat e Italisë së lirë); prandaj duhet të jetë serioz, konciz dhe i saktë. Flisni shkurtimisht për gjendjen e ushtrisë italiane gjatë shembjes së fashizmit, tradhtinë e oficerëve të lartë, të korruptuar nga fashizmi, gjendjen shpirtërore të ushtarit në ato kohëra dhe sot, kontributin në gjak, dëshmorët (origjina e tyre: punëtorë, fshatarë, intelektualë etj.) luftimet, vdekjet e shkaktuara në radhët e armikut dhe dëmet e shkaktuara atij etj. Ushitari italian, bir i denjë i popullit të tij, në radhët e "U.N.Ç.SH. (Ushtria Nacional-Çlirimtare Shqiptare), si në ato të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Jugosllave, shpagon me gjakun e saj turpin e fashizmit vrasës të popujve; krahas partizanëve shqiptarë, partizanët italianë marshojnë për të njëjtën çështje të shenjtë dhe të drejtë në betejat kundër të njëjtit armik, për lirinë e popujve, për vdekjen e xhelatëve fashistë dhe për hakmarrje". *AQSH*, F. 177, V. 1944, D. 15, fl. 3. Letër në italisht dërguar komandës "Gramsci" nga Andrea Varfi, në emër të Agitprop të Divizionit I-rë Sulmues shqiptar, më 22 tetor 1944.

³³ *Po aty*, F. 177, V. 1943, D. 33, fl. 20. "Relazione sull'attività" (pa datë).

³⁴ M. Fantacci, "Un italiano in Albania (III)"..., f. 14. Fantacci sjell si datë krijimi të batalionit 10 tetorin, e cila është gjithashtu e pranishme në "Ditarin historik-ushtarak" [*Diario storico-militare*] të vetë batalionit: *AQSH*, F.177, V. 1943, D. 33, fl. 29.

Shehu - komandanti i Brigadës I Sulmuese, në gjirin e së cilës bashkëngjitet batalioni - për nder të prejardhjes arbëreshe që besohej se kishte (siç dhe vetë pati shënuar) themeluesi i Partisë Komuniste të Italisë. Vendimi ndiqte njëkohësisht bindjen e përgjithshme se italianët e përfshirë në të gëzonin që në zanafillë kredenciale të mjaftueshme komuniste; ndonëse kjo frymë ideologjike ishte, siç pranonte vite më vonë dhe komisari i parë i batalionit, Bruno Brunetti, tejet e paqartë dhe e vakët, duke qenë se kryefjala që i udhëhiqte ata ish ushtarë ndiqte arsyen e përshtatjes ndaj rrethanave (cit. *viva chi regna* – rroftë sundimtari), e shumë anëtarë të reparteve fashiste “kaluan në radhët partizane duke u kthyer në shokë të mirë”.³⁵

Në krye të pjesëmarrësve të parë (137 vullnetarë³⁶ të ardhur nga divizionet “Firenze” dhe “Arezzo, të cilët, pas këshillës së Shehut, u ndanë formalisht në luftëtarë dhe punëtorë) u urdhërua nëntogeri Terzilio Cardinali³⁷, i shquar për antifashizmin e tij (çka i kishte kushtuar, siç deklarohet, degradimin në rreshter major³⁸), e nismëtar i një fryme antihierarkiste në brendinë e batalionit. Kjo dëshmohet nga betimi që Cardinali, në themelim të batalionit, bëri para njerëzve të vet me qëllimin që të mos i hapej dera asnjë oficeri, pasi askush brenda “Gramsci”-t nuk duhej “të përfitonte nga gradat”.³⁹ Një qasje e tillë përfaqësonte një çarje të hapur (dhe “turpëruese”, siç do të gjykohej tjetërkund) me logjikën organizuese të CMTM-së⁴⁰, duke iu nënshtruar kësodore direktivave të

³⁵ B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 39.

³⁶ Këtyre do t’u shtohen, sipas listës së pranishme në dokumentacion, përpiluar nga Mehmet Shehu, 20 radiotelegrafistë dhe një aradhë municionesh e armësh. *AQSH*, F. 177, V. 1943, D. 32, Lista nr. 1, 12 tetor 1943.

³⁷ *Enciclopedia dell’antifascismo e della Resistenza*, vol. I A-C, A.A.V.V. Milano: La Pietra editore, 1968, f. 458. Cardinali, në këtë material, jepet si rreshter i divizionit “Arezzo”; shih gjithashtu: Alfonso Bartolini, “Terzilio Cardinali: un ambasciatore di pace in Albania”, in *Patria indipendente*, (XXI), Roma: 15 ottobre 1972, f. 11; Francesco Lelmi, “La “Gramsci” unità partigiana italiana in Albania”, *Patria indipendente*, (XXVII), Roma: 16 settembre 1979, nr. 15, *passim*.

³⁸ *AQSH*, F. 177, V. 1943, D. 33/1, fl. 1. Dokumenti nuk ka datë.

³⁹ *Diario storico-militare del battaglione...*, f. 32.

⁴⁰ Sipas V. Azzi-t, përzgjedhja e komandantëve të batalionit në mesin e ushtarëve të thjeshtë nga ana e drejtuesve partizanë shqiptarë, nuk ishte e zakonshme as për vetë Lëvizjen Nacionalçlirimtare (në të cilën krerët zgjidheshin në bazë të marrëdhënieve që këta gëzonin me Partinë Komuniste, përveçse për shkak të rezultateve që mund të kishin korrur në operacione luftarake). V. Azzi, *I disobbedienti della 9°...*, f. 320.

Ushtrisë Nacionalçlirimtare.⁴¹ Sidoqoftë, Cardinali i mbeti besnik fjalës së vet, duke refuzuar kërkesën për anëtarësim të disa oficerëve pak ditë më vonë, duke theksuar kësaj linjë e ashpër politike të batalionit.⁴²

Mandej, rëndësi të posaçme do të kishte gjithashtu vendosja e komisarariatit politik, pranë komandantit, me të njëjtën peshë drejtuese; veprim i cili ndiqte përvojën tashmë të zbatuar kudo nga partizanët shqiptarë, nën ndikimin e shembullit jugosllav⁴³, e që ishte gjithashtu e pranishme në brigadat komuniste “Garibaldi” në territorin italian.⁴⁴ Batalioni u nda në tre nënreparte, me nga tri toga, e përkatësisht tre komisarë, secili. Në përfundim, u përshtat edhe një flamur përfaqësues, që ishte tringjyrëshi italian i pajisur me emërtesën “A. Gramsci” në vend të emblemës mbretërore italiane (kryqit sabaud).⁴⁵

4. E pavarësisht parakushteve shpresëdhënëse dhe moralit të lartë⁴⁶, marrëdhëniet mes gramshianëve dhe partizanëve shqiptarë nuk shkuan

⁴¹ Që kjo frymë antihierarkiste e “gramshianëve” e kishte zanafillën në vetë eprorët e tyre shqiptarë, duket edhe nga pohimet e Fantacci-t, i cili na përcjell dëshminë e një majori kalorësie të quajtur Carboni - i përfshirë sakaq në brigadën e Shehut, por jo në radhët e “Gramsci-t” - që nënvizon fërkimet mes partizanëve shqiptarë dhe oficerëve italianë: “Ai pranoi se nuk ia dilte dot më që të merrej me sflitjet e gueriljes, edhe sepse komandantët shqiptarë të brigadës nuk ishin asfare miqësorë me të, shkak për të cilën ishte përherë ajo mëri që shqiptarët kishin përkundrejt oficerëve italianë, veçanërisht nëse bëhej fjalë për oficerë madhorë”. (M. Fantacci, “Un italiano in Albania (III)...”, f. 13).

⁴² B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 25-29.

⁴³ Për sa i përket rastit jugosllav, shih: Lefter Kasneci, *Steeled in the Heat of Battle. A Brief Survey of the National Liberation War of the Albanian People*, Tiranë: Naim Frashëri, 1966, f. 25; gjithashtu: Mario Fantacci, “Un italiano in Albania” (II), në *Il movimento di liberazione in Italia*, a cura dell’Istituto nazionale per la Storia del Movimento di Liberazione in Italia, nr. 41, Milano: marzo 1956, f. 44.

⁴⁴ F. Chabod, *L’Italia contemporanea...*, f. 131.

⁴⁵ Ndreçi Plasari, *Shpresë për popullin, tmerr për armikun: mbi jetën dhe luftën e Brigadës I Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare*, Tiranë: 8 Nëntori, 1977, f. 75-76; shih edhe Gian Battista Cavallotto, “Così divenni partigiano”, në *Patria indipendente*, (XXVII), Roma: 7 ottobre 1979, nr. 16, *passim*.

⁴⁶ Antonella Fiorio, “Resistere in Albania: la formazione partigiana “Antonio Gramsci” nella lotta di liberazione dal nazifascismo”, në *Così vicini, così lontani. La prossimità italo-albanese dalle origini del secolo breve alla Resistenza*, a cura di Antonella Fiorio, Vito Saracino, Bari: Besa, 2020, f. 64-65.

përnjëherë vaj.⁴⁷ Mosbesimi i ndërsjellë, që ishte më i hershëm se ujdia e tetorit 1943, vështirë se mund të anashkalohej, me gjithë vullnetin e qartë për t'u kapërcyer nga të dyja palët.⁴⁸ Njëkohësisht, lypset të mbahet parasysh se pjesëmarrja italiane në veprimtarinë e Brigadës I Sulmuese nuk kishte veç qëllime politike të lidhura me Luftën Nacionalçlirimtare të shqiptarëve; e as mund të thuhet se përmes saj, në njëfarë mënyre, veç paguhej një haraç me shpresën e një riatdhesimi me nder e sa më të qetë. Të paktën sipas dëshmimeve të mëvonshme, Shehu, që ishte njëkohësisht arkitekti i cili qëndronte mbas këtij shtrëngimi duarsh, e shihte bashkërendimin mes dy palëve si parathënie të “luftës ndaj fashizmit, armik i popujve, deri në shkatërrimin e tij të plotë”⁴⁹ edhe mbi truall italian, duke lënë të kuptohej një lidhje, së paku parimore, mes komunistëve shqiptarë dhe antifashistëve të Partisë Komuniste Italiane.

Telashet, gjithsesi, nuk munguan. Njëra prej tyre, e cila shenjoji që në fillim dhe në mënyrë tragjike ecurinë e gramshianëve në këtë fazë të Luftës II Botërore në Shqipëri, ishte edhe përleshja në hyrje të Beratit me forcat gjermane që mbikëqyrnin aeroportin ushtarak të atjeshëm, në agimin e datës 15 nëntor. Këto të fundit, të shoqëruara nga një numër bashkëpunëtorësh nacionalistë, ndërmorën një sulm të beftë ndaj një vatre partizane të ngritur fare afër, ku gjendej vetë batalioni “Gramsci”, një tjetër i CMTM-së, si dhe bateritë italiane “Menegazzi” dhe “Cotta”, nën urdhrat e drejtpërdrejtë të komandës së LANÇ-it.⁵⁰ Pas plot pesë orësh përpjekjeje sfilitëse për të mbrojtur krahun e majtë të frontit, siç u ishte ngarkuar italianëve (teksta e djathta mbrohej nga një batalion shqiptar), “Gramsci” gjendej pranë shfarosjes përfundimtare dhe krejtësisht i dërrmuar para trupave gjermane, shumë më të pajisura dhe të

⁴⁷ Emërimi i një shqiptari, partizanit Sami Kotherja, në këshillin drejtues të batalionit, që në tërësi kishte pesë anëtarë, pasqyronte me shumë mundësi këtë ngërç fillestar. Të paktën kështu duket në disa burime shqiptare. Shih: N. Plasari, *Shpresë për popullin...*, f. 63.

⁴⁸ “Partizanët shqiptarë janë shumë të përzemërt me ne dhe përpiqen me lloj-lloj mënyrash për të na shfaqur miqësi të pastërt, pavarësisht se ç’kanë hequr.” “Diario storico-militare del battaglione”, në *AQSH*, F. 177, D. 33, fl. 32.

⁴⁹ B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 32.

⁵⁰ Duket se sulmi, i cili rezultoi pas një spiunimi që, siç rrëfëhet, erdhi nga ish kreu i batalionit II të brigadës, Xhelal Staravecka, goditi veç “Gramsci”-n, pasi dy bateritë e tjera italiane ishin larguar rastësisht përpara kohe. “Diario storico-militare...”, fl. 33.

organizuar.⁵¹ Veç një grusht prej atyre të mbetur ende gjallë, me në krye komandantin Cardinali, arritën të tejkalonin linjat armike, me Beratin përfundimisht në duart e gjermanëve, e të shpëtonin përmes lumit Osum.

Nuk është fort i qartë numri i humbjeve⁵² – pasi nuk ka dakordësi të plotë as mbi sa njerëz kishin përqaftuar batalionin deri në gjysmë të nëntorit 1943 – porse ishte bindshëm e qartë se me rreth 48-50 të mbijetuar, “Gramsci” ishte në prag të shpërndarjes, veç një muaj nga ngritja e vet. Çka e mbajti në këmbë, si simbol e si njësi ushtarake, ishte veç vullneti politik i drejtuesve të LANÇ-it, mbase për shkak të identitetit politik – pse jo dhe atij etnik – që “Gramsci” përfaqësonte. Sakaq që formacionet e tjera partizane dhe ushtarake italiane nuk duket se e morën më veten pas shpartallimit në Berat, vetë Shehu pohohet të ketë premtuar, me patos të lartë, synimin e vet për ringritjen e batalionit; madje, duke paralajmëruar (e këtu dëshmia vlen të trajtohet me shumë kujdes) përfshirjen e “Gramsci”-t në aktin fundor të çlirimit, kurdo që këtij t’i vinte radha.⁵³ Asgjë e tillë nuk u tha për italianët e tjerë të grumbulluar në njësi që gjithashtu nuk bënë pak punë brenda lëvizjes partizane shqiptare.⁵⁴

⁵¹ Veçanërisht mbi këtë ngjarje, shih: Bruno Brunetti, “La battaglia di Berat”, në *Liri Popullit. Partigiani italiani in Albania. Un esempio di internazionalismo proletario*, Firenze: Cultura editrice, 1974, f. 65-74, si dhe Alfonso Bartolini, *La Resistenza italiana all'estero*, Padova: Rebellato, 1965, f. 251. Sipas të dhënave që mund të grumbullohen nga Ditari i batalionit (“Diario storico-militare...”, fl. 31), atë ditë humbën jetën 145 trupa gramshiane. Në librin e vet të kujtimeve, sakaq, Brunetti thotë se në Berat vdiqën 120 anëtarë, nga 170 në tërësi që “Gramsci” kishte arritur të mblihdte deri atëherë. Bruno Brunetti, “Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda dei Alfredo Sebastiani”, in *Documenti e studi. Rivista dell'Istituto Storico della Resistenza in Provincia di Lucca*, nr. 4 giugno 1986, f. 53.

⁵² “Shumë shokë vdiqën duke përshkuar lumin Osum; shumë të tjerë u zunë rob [...] Disa shokë shqiptarë, që veç më vonë mundën të dalin nga Berati, na thanë se gjermanët kishin vrrarë të gjithë partizanët (fjala e fundit në dokument është fshirë me një vizë – E.Q.) italianë.” “Diario storico-militare...”, fl. 33-34.

⁵³ “Batalioni ‘Antonio Gramsci’ nuk ka vdekur: ai do të vazhdojë, tok me ne, marshimin deri në fitoren përfundimtare. Vdekje fashizmit!”. B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 72.

⁵⁴ Siç u pa, përveç batalionit “Gramsci”, në brendi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare vepronin njësi të tjera italiane që jepnin një ndihmë të madhe për partizanët shqiptarë, sidomos në lëmin e artillerisë ku këta të fundit nuk shquheshin. M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani all'estero...*, f. 768-769. Një histori e shkurtër dhe përmbledhëse e baterisë “Menegazzi”, në të cilën nuk kursehen lëvdatat ndaj Brigadës I Sulmuese, në organikën e së cilës ishte e përfshirë edhe kjo bateri, u hartua në

Dimri që ndoqi, në kapërcyell të viteve 1943 dhe 1944, paraqitej i vështirë por edhe i heshtur, pasi vetë ditari i batalionit nuk ka gjurmë shënimesh, të paktën deri në majin e pranverës pasardhëse.⁵⁵ Gjasat janë që kjo kohë të jetë shpenzuar për të trajtësuar nga e para përbërjen e “Gramsci”-t, duke e pasuruar atë me rekrutë të rinj, të ardhur si nga elementët e tjerë italianë të shpërndarë në njësitë e Brigadës I, ashtu edhe duke përcjellë në të, përmes thirrjeve në zonat rurale, njerëz që deri në atë kohë nuk ishin përfshirë në luftë por qëndronin të strehuar.⁵⁶ Vetë akti i rindërtimit të së vetmes njësi komuniste italiane, një parësi për qëllimet politike të LANÇ-it, u shoqërua me rritje të angazhimit ideologjik (elementi i bashkëpunimit dhe vëllazërimit mes popujve, përtej ndasive kombëtare) që duhej të karakterizonte veprimtarinë luftarake të një grushti italianësh të cilët synonin çlirimin e shqiptarëve jo vetëm nga një pushtues, por edhe nga vargonj të tjerë të rendit socio-ekonomik. Ky të paktën paraqitej si qëllimi i epërm i propagandës përfshirëse, e cila theksonte edhe më tepër prejardhjen e ulët shoqërore të atyre që radhiteshin në batalion, gjë që i bashkonte deri në njësim me shqiptarët.⁵⁷ Në vijimësi, me përmirësimin e numrave dhe të organizimit të përgjithshëm, nisën edhe konferencat divulguese mes grupeve partizane, që mund të gjykohen si njëfarë shtyese formuese por edhe motivuese për njerëz, të cilët vështirë se zotëronin dije politike përtej ndonjë ideje a populizmi të vagullt.⁵⁸

përfundim të luftës nga vetë kreu i saj, Vito Menegazzi, drejtuar majorit të misionit britanik në Shqipëri, Reginald Hibbert. Shih, vëllimin e tij të përkthyer në shqip: Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f. 384-385.

⁵⁵ Batalioni, përgjatë dimrit, duhet të ketë pasur rreth 50-60 trupa në përbërjen e vet. Shih: M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani all'estero ...*, f. 846.

⁵⁶ “Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda dei Alfredo Sebastiani...”, f. 53-55.

⁵⁷ Shih: Joyce Lussu, “Contadini italiani nelle formazioni partigiane in terra albanese”, në *Patria indipendente*, XXXI, Roma: 19 dicembre 1982, nr. 21-22. “Internacionalja” dhe “Bandiera rossa”, shkruhet në ditarin e batalionit (fl. 32), ishin këngët më të shpeshta të kësaj kohe. Disa të tjera janë përmbledhur në një *dossier*, që gjendet në *AQSH*, F. 177, V. 1944, D. 9.

⁵⁸ Dëshmon kështu komisarri Brunetti, njeriu kyç i batalionit për sa i përket shëndetit ideologjik, nëse mund të shprehemi kështu, të partizanëve italianë. “Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda di Alfredo...”, f. 56. Veprimtaria e ngjeshur politike në Brigadën I mund të ndiqet edhe në: *AQSH/ Arkivi i Partisë së Punës (APP)*, F. 14, V. 1944, D. 49, fl. 1-3 dhe 20-21, datë 16 prill dhe 4-5 korrik 1944. Vullnetit të italianëve në këtë drejtim, krerët shqiptarë i përgjigjen me shpërndarje materialesh

Kjo manovër politike, e cila, duke injektuar elemente ideologjike të papranishme deri në atë çast në luftë, i kthente italianët e “Gramsci”-t në shembuj të metamorfozës së vetë konfliktit: nga çlirues në revolucionarë; nga përpjekje kundër pushtuesit të huaj, në paravijën e një ndryshimi të madh epokal, që prekte të huajin por edhe veten. E ky trajtim/trajnim i “Gramsci”-t ishte një miniaturë e vërtetë e të njëjtit proces që do të përfshinte gjithë veprimtarinë e PKS-së, pasi ideologjizimi nuk ishte thjesht i rezervuar vetëm për italianët e rekrutuar në LANÇ, por edhe ndaj vetë radhëve të partizanëve shqiptarë. Kjo tregon se roli i komunistëve të Hoxhës, duke nisur nga fundi i vitit 1943, po rriste ndikimin e vet mbi Frontin Nacionalçlirimtar dhe larushinë e faktorëve të përfshirë fillimisht në të. Italianët i duheshin PKS-së dhe Hoxhës pikërisht për këtë funksion - dhe u duheshin komunistë të sprovuar - çka u jepte mundësinë që luftës ndaj pushtuesit t’i bashkëngjisnin elementë ideologjikë thelbësisht të ndryshëm nga një rrekje e thjeshtë nacionalçlirimtare. Në këtë mënyrë, siç armiku do të ishte diçka më shumë se i huaj – fashist, por edhe bashkëpunëtor vendas – ashtu edhe çliruesi do të ishte diçka më shumë se patriot – pra edhe komunist, e madje edhe internacionalist.

Sidoqoftë, një muaj para çlirimit të vendit – e plot një vit nga themelimi i batalionit - bëhet e qartë në një dokument se procesi i "konvertimit" të italianëve në partizanë komunistë linte shumë për të dëshiruar. Shkaku kryesor ishte mungesa e strukturave dhe e personelit të përshtatshëm a të aftë për të bashkëbiseduar në italisht brenda Brigadës I. Siç tregojnë dëshmitë e disa kuadrove partizanë, diskutimeve politike u mungonte kryekëput serioziteti.⁵⁹ Të zëvendësoje mallin për atdheun me një zell të cekët antifashist nuk kishte qenë asfare e lehtë⁶⁰; madje edhe për këta të rinj të etur për shpagimin e së kaluarës së tyre si okupatorë fashistë, e që shpesh dërgoheshin në betejë si ndonjë legjion i huaj përherë i gatshëm për t’u sakrifikuar. Megjithëse disa prej djelmoshave

librore të përkthyer enkas në gjuhën e tyre. “Të gjithë duan Partinë dhe thonë se janë komunistë”, raportohet në një shënim. *Po aty*, fl. 9, datë 28 prill 1944. Në vijim, ngrihet madje edhe një kompani teatrore, për qëllime dëfrimi, siç ndodhte edhe në batalione të tjera, ku qëllimet e propagandimit ideor dhe ideologjik ishin të kuptueshme. *Po aty*, F. 77, V. 1944, D. 33, fl. 35. Mbi teatrin partizan shih edhe Bruno Brunetti, “Teatro in montagna”, në *Albania oggi*, nr. 3, Roma: luglio-settembre, 1973, f. 15; cituar edhe në *Liri Popullit. Partigiani italiani in Albania. ...*, f. 89-93.

⁵⁹ *AQSH/APP*, F. 14, V. 1944, D. 49, fl. 46, 30 tetor 1944.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 55, 31 dhjetor 1944.

ishin tanimë anëtarë të Partisë Komuniste shqiptare⁶¹ dhe ishin "të vullnetshëm të mësonin", u pranua me hidhërim se ata "[nuk] kishin pasur materialet e duhura, madje as një broshurë në gjuhën e tyre".⁶²

Të tilla zhvillime arritën sidoqoftë të sakatonin, pavarësisht se jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, kompaktësinë e CMTM-së. Afërmendsh, qëllimi kryesor i udhëheqësve të LANÇ-it, përkundrejt atyre të CMTM-së, ishte që të nxirrmin në pah shembuj pozitivë të italianëve "të vet", duke nxitur kësisoj të tjerë, ndër ata të mbetur nën urdhrat e Azzi-it, që të shkëputeshin dhe t'i bashkoheshin luftës së udhëhequr nga komunistët shqiptarë. Mes vetë partizanëve italianë, duhet thënë, nuk qenë të rralla ndjenjat e përçmimit për ish kolegët bashkëkombës të tyre, që kishin parapëlqyer togat e vjetra ndaj luftës partizane.⁶³ Kjo taktikë përçarjeje nuk mbeti pa rezultate të vrojtueshme në popullatë, që me sa duket, tregohej goxha dashamirëse për të ndihmuar partizanët (shqiptarë apo italianë qofshin), por të mbetej mospërfillëse karshi reparteve ushtarake të Azzi-t. Këto, në mungesë të mbështetjes logjistike që mund të gëzonin bazat partizane, e duke qenë të izoluar nga përkrahja dhe strehimi i civilëve, erdhën duke u shpërndarë apo duke u izoluar edhe më tej në male.⁶⁴

"Në të tillë situatë të nderë, ushtarakët tanë nuk kishin zgjedhje tjetër veç t'i bashkoheshin, ku u jepej mundësia, njërive partizane shqiptare, pasi, përbrenda këtyre arrinin të kishin, së paku, kushtet minimale që të mos mbeteshin pre të urisë apo të ngricës. Ata që nuk mundën – e ishin shumë – të gjenin vend në radhët partizane iu bashkuan turmës së atyre fatzinjve të cilët, teksa endeshin përmes shtigjeve që nuk çonin kund nëpër male, kalonin nga fshati në fshat duke kërkuar punë në këmbim të një koreje bukë."⁶⁵

⁶¹ Pohohet në një raport se plot 92 anëtarë të "Gramsci"-t ishin anëtarësuar në PKSH. Disa, si vetë Brunetti, më 16 mars të një viti më vonë, u dekoruan me Urdhrin "Ylli Partizan", klasi i dytë. *AQSH*, F. 177, V. 1944, D. 2, fl. 13-14. Dokument pa një datë të saktë, por vetëm "1943-1944".

⁶² *AQSH*, F. 14, V. 1944, D. 49, fl. 55.

⁶³ Duke përshkruar një çadër angleze, Brunetti, si komisar politik i konsoliduar i batalionit tashmë, shkruan: "Komanda angleze përbëhej nga vetëm dy ushtarë, një nënoficer dhe një operator radiotelegrafi, një ushtar italian, lëpirës i zakonshëm që sillet si shërbëtori i tyre". B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 97.

⁶⁴ Ndaj ushtarëve italianë, pohon Fantacci, mbetej ndjenja e vjetër dyshuese, "pavarësisht se kjo ishte zbutur goxha në krahasim me ditët e para të armpushimit". M. Fantacci, "Un italiano in Albania (III)...", f. 12.

⁶⁵ V. Azzi, *I disobbedienti della...*, f. 266.

Si rrjedhim, në qershor 1944, u konsumua edhe dalja përfundimtare prej skene e CMTM-së, pas shumë e shumë përplasjesh, kurrë të tejkaluara, si dhe pushkatimit të tre oficerëve italianë nga komunistët shqiptarë nën akuzën e spiunazhit në favor të gjermanëve. Vetë trysnia, në drejtim të krerëve ushtarakë italianë, që të ndiqnin urdhrat e LANÇ-it, nuk u zbeh kurrë. Elozhet që thureshin në vazhdimësi për djemtë e “Gramsci”-t (të cilët përgatiteshin ndërkohë të kalonin nga struktura e një batalioni në atë të një brigade, duke përfshirë në të edhe italianë të tjerë me prejardhje nga rangjet ushtarake) ishte pjesë e skenarit. E përtej kësaj, do të ishte e pamundur të mos theksohej, se pavarësisht shtrëngesave të shkaktuara qëllimisht, CMTM-ja zor se arriti ndonjëherë të përshtatej me terrenin dhe kushtet jashtëzakonisht të vështira të luftës, pa përmendur, në fund, ndihmën e shumëkërkuar por që kurrë nuk erdhi nga Aleatët (sidomos në armatime dhe veshmbathje). Së paku, anglo-amerikanët u treguan vendimtarë në procesin e riatdhesimit të asaj mase ende të papërcaktuar ushtarësh të mbijetuar.⁶⁶

5. Siç ishte fare lehtë e parashikueshme, nami që dita-ditës i bashkëngjitej emrit të batalionit “Gramsci”, fakti që ata djem të huaj përherë e më shumë konsideroheshin “më shumë tanët se të tyre”, do të kushtonte jo pak në terma lirie për të vepruar. Në të vërtetë, qysh përpara

⁶⁶ M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 863; *po aty*, shih edhe f. 873, 893; V. Azzi, *I disobbedienti della...*, f. 268-269, 276. Duke u mbështetur në dokumentacionin gjerman – por që nuk mund të ballafaqohet me burime të tjera – vetë Azzi, në shkurt të 1944-s, thuhet të ketë marrë përsipër mundësinë e një dorëzimi të 3500 trupave të veta te gjermanët, për shkak të pamundësisë njerëzore për ta përballur situatën në male. Sipas kësaj qasjeje dokumentare, mbi të cilën mund të ngrihen mjaft dyshime, shqiptarët nuk do ta lejonin kurrë një hap të tillë, pasi mund të shkaktonte “një dëm të rëndë mbi moralin dhe aftësinë për të zgjedhur të gjithë atyre italianëve që ishin pjesë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare”. Coltrinari sjell këtë version – të përmbajtur, në pjesën më të madhe, në ditarin historik të Korparmatës XXI gjermane, si dhe në komunikimin shtjellues mes komandës dhe njësisë vartëse – porse nuk i beson shumë vërtetësisë së tij; siç nuk i zë besë as vullnetit të mirë të partizanëve shqiptarë për ta shmangur atë akt dëshpërimi. Shkruan hamendthi, përkundër, se ishin shqiptarët të cilët, në padije të Azzi-t dhe *a regola d'arte* shpërmdanë lajmin në mënyrë që të zhduknin çfarëdolloj pranie të CMTM-së në Shqipëri. Në mbështetje të tezës së tij duket se është qëndrimi i mëvonshëm i Azzi-t i cili dokumentohet se pas ofertës britanike për të organizuar riatdhesimin e trupave të CMTM-së, kundërshtoi duke u rrekur të bindte aleatët për vazhdimin e betejës ndaj nazistëve në Shqipëri, pavarësisht kushteve të ndera të njerëzve të tij. M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 860-862.

se italianët e tjerë të CMTM-së të tërhiqeshin përfundimisht nga luftimet, gramshianët nuk reshtën së qeni të pranishëm, nën urdhrat e krerëve të Brigadës I Sulmuese, në të gjitha operacionet guerilase të ndërmarra.

Të tilla ishin ato të marsit 1944, për çlirimin e disa fshatrave në Shqipërinë e Mesme, ku kjo *légion étrangère* u përdor në mënyrë të ngjeshur. Ndërsa në raste të tjera, siç ishte kërkesa e vetë batalionit për t'u angazhuar në lirimimin e rreth 400 italianëve të mbajtur peng nga forcat gjermane në zonën e Belshit, drejtuesit e brigadës refuzuan kategorikisht, pasi një orvatje e tillë nuk i përgjigjej, siç dukej, planeve paraprahe.⁶⁷ Kjo shpjegon edhe nivelin pothuajse të papërfillshëm të autonomisë që “Gramsci” gëzonte në kuadër të organikës nacionalçlirimtare.

U desh të pritej deri në maj, pas zhvillimit të kongresit të mbajtur në Përmet – prej nga doli një qeveri e përkohshme – që gramshianëve, të cilët kishin marrë përsipër rolin e zinxhirit të sigurisë gjatë zhvillimit të punimeve, t'u jepej leja për rrethimin e Belshit.⁶⁸ Për fatin e tyre të keq, ajo sipërmarrje u bitis si mos më keq, jo vetëm në lidhje me taktikat sulmuese që ishin përcaktuar në tavolinë me Brigadën I, por edhe për sa i përket respektimit të rregullave të rrepta mbi të cilat regjej çfarëdolloj nisme guerilase (mes tyre, nevoja e një sulmi të befasishëm, si dhe afatet e ngushta kohore që lypse rasti⁶⁹). Një dështim i këtij lloji, i dha shkak shqiptarëve që jo vetëm të kritikonin gabimet e batalionit, por edhe t'u vinin fre çfarëdolloj kërkesë për të vepruar lirisht në të ardhmen. Qëndrimi i Mehmet Shehut duket të ketë qenë tejet i ashpër, sidomos për sa i përket grackës në të cilën gramshianët ranë kur pranuan të humbnin kohë në negociata me gjermanët e rrethuar. Teksa akuzoi komandën e “Gramsci”-t se me thyerjen e disiplinës kishin dëmtuar unitetin partizan të të gjithë brigadës, kreu i saj theksoi humbjen e një jete të çmuar përgjatë gjithë zhvillimit të aksionit (atë të partizanit Aurelio Storaci).⁷⁰

⁶⁷ B. Brunetti, “Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda dei Alfredo Sebastiani...”, f. 45.

⁶⁸ “Diario storico-militare...”, fl. 44/1-45.

⁶⁹ “[N]ëse aksioni nuk do të kishte përfunduar brenda dy orësh, [“Gramsci”] do të duhej të kthehej në folenë e vet, duke qenë se në të njëjtën kohë ishte vënë në veprim një operacion spastrimi nga ana e gjermanëve, e brigada dukej të mbetej e bashkuar.” M. Fantacci, “Un italiano in Albania (III)...”, f. 14.

⁷⁰ “Nuk u jeni bindur urdhrave dhe keni gabuar plotësisht, jeni treguar naivë [...] Ushtria jonë Nacionalçlirimtare është një familje e madhe, një familje shumë e disiplinuar që nuk do të donte kurrë të humbiste asnjë nga bijtë e vet. Vëreni vath në vesh këtë gjë”. B. Brunetti, *Da oppressori a combattenti per la libertà...*, f. 95.

Paradoksalisht, emri që “Gramsci” gëzonte deri atëherë nuk pësoi ndonjë goditje pas tronditjes së Belshit⁷¹, ndonëse ishte e qartë se marrëdhënia e batalionit italian me krerët e lartë të LANÇ-it do të pësonte ndryshime të tjera. Në strukturën e vet të brendshme, batalioni edhe mund të vazhdonte nën një regjim pa grada; porse kjo gjë nuk vlente për sa i përket inkuadrimit të “Gramsci”-t në logjikën disiplinore dhe vertikaliste të Brigadës I, prej së cilës varej plotësisht.

Muajt e vështirë të verës 1944, e cila nisi mes masash të jashtëzakonshme gjermane që kulmuan në të ashtuquajturin *Junioperation* (Operacion i Qershorit), ndoqën pikërisht këtë prirje. Pjesëtarëve të batalionit, të cilët tani endeshin nëpër fshatrat e Shqipërisë Jugore pa mbështetjen e partizanëve shqiptarë, qartazi nuk u munguan rastet e përplasjeve me njësi të përziera gjermano-balliste. Dëshmohet gjithashtu se popullata, siç duket nga frika e hakmarrjeve të mundshme apo armiqësive të vjetra të mbetura pezull, nuk sillej gjithmonë në mënyrë miqësore me ta.⁷²

Megjithëkëtë, me zbehjen e shtrëngesave gjermane, si dhe ecurinë e muajve verorë, duket se edhe ky ngërç kaloi. Në përgjithësi, me kalimin e kohës dokumentohet një qasje më dashamirëse e popullatës ndaj partizanëve; e këta të fundit duket se shtynë për një afrim më të madh mes gjithë elementëve të përfshirë në radhët e tyre (edhe italianëve pra) dhe civilëve.⁷³ Ishte gjithashtu e natyrshme që, teksa konfliktit i afrohej fundi, nga shumë anë të rriteshin kërkesat për t’u bashkuar me atë palë që dukej se do të merrte trofeun e fitores; e një gjë e tillë ndodhte si me shqiptarët, ashtu edhe me ata italianë që deri në atë çast kishin qëndruar

⁷¹ Batalioni “megjithëse i shtresëzuar me ish nënoficerë, të graduar apo ushtarë, kishte dhënë prova të tilla që veprimet e veta epike njiheshin ngado në Shqipëri”. Për të tillë shkak, kur bie fjala për Belshin, duhej të ndiheshin krenarë, “që kishin detyruar një oficer fodull gjerman që të ulej e të kuvendonte me një komandant partizan italian, që për të parin kishte qenë veç një rrugaç i jashtëligjshëm.” M. Fantacci, “Un italiano in Albania (III)...”, f. 14-15.

⁷² Pjesëmarrësit në këto zhvillime flasin për një popullatë civile e karakterizuar nga “sjellje mospërfillëse”, e cila nuk “simpatizonte aspak” për gramshianët, dhe në disa raste gjente “justifikime për të mos na ushqyer”. B. Brunetti, *Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda dei Alfredo Sebastiani...*, f. 45-52.

⁷³ Sebastiani tregon për intervistën që një gazetar, me gjasa pranë komunistëve, i bën komisarit të batalionit, Brunetti-t, ku kërkon “lajme në lidhje me veprimtarinë e kryer nga batalioni në mënyrë që t’u japë jehonë, përmes shtypit, epopesë së Gramsci-t dhe veprave të heronjve të tij.” Po aty, f. 50.

të strehuar në zonat rurale, duke parë tashmë tek anëtarësimi partizan mundësinë më të shpejtë për riatdhesim.⁷⁴ Si përfundim, mendohet se në vjeshtën e vitit 1944, numri i italianëve aktivë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare kapte shifrën e 2 000 trupave. Kësodore, komanda shqiptare vendosi që më të dalluarve prej tyre t'u akordonte gradat ushtarake që dhe vetë adoptonte.⁷⁵

6. Në shtatorin e vitit 1944, "Gramsci" goditet rëndë nga humbja e komandantit të vet Terziglio Cardinali⁷⁶, i rënë në përlëshjen e egër që batalioni pati me një njësi armike në zonën e Dibërës.⁷⁷ Ngjarja, gjithsesi nuk pengoi rreshtimin e partizanëve italianë në gatishmëri për marrjen e Tiranës. Gjatë rrethimit të kryeqytetit, me 120 të plagosur dhe 20 të

⁷⁴ Shehu vetë, shkruan Sebastiani "na siguroi për zbarkimin e Aleatëve në Shqipëri", duke iu referuar operacioneve të marinës që do të riatdhesonin italianët nga Shqipëria. Ai gjithashtu "konfirmoi premtimin se së shpejti do të shkojmë në Itali të veshur siç duhet dhe të armatosur". Po aty, f. 49-50.

⁷⁵ M. Fantacci, "Un italiano in Albania (III)...", f. 22, 26-28.

⁷⁶ "Kompania "Gramsci", si në shumë raste të tjera, u la e zbuluar nga tërheqja e papritur e shqiptarëve. E zbuluar nga të gjitha anët, ajo do të ishte e dënuar me shkatërrim; prandaj, duke ndjerë rrezikun e madh, nën zjarrin e gjermanëve, dhe gati të shpërndahet, Kardinali bërtet dhe fyen njerëzit e tij, tashmë të panikosur, dhe ngrihet nga streha për t'i nxitur ata që të mos tërhiqen, sakaq që duhej, pikërisht duke ndjekur taktikën partizane, që të bënte çmos për të shpëtuar lëkurën e vet. Por krenaria e tij si komandant dhe guximi i tij personal vendosin fundin dhe ai, në atë moment, bie. Humbja e Kardinalit përfaqësoi një humbje serioze që do të ndikojë në efikasitetin e batalionit deri në fund të luftës". Ky përshkrim nga Coltrinari (M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani...*, f. 905) mbështetet mbi dëshminë e mbledhur nga James Bonora në *Diario*, Carteggio Bonora-Malagoli, archivio COREMITE). Shih gjithashtu: M. Fantacci, "Un italiano in Albania (III)...", f. 22-30.

⁷⁷ Cilësimet heroike dhe hiperbolat janë, siç kuptohet, veçanërisht të pranishme në raportin që përshkruan vdekjen e Cardinali-it, i cili, thuhet të ketë pohuar para grahmës së fundit: "Vazhdoni sulmin, shokë... Unë po vdes... Jam i lumtur... Vdes për ideal... Rroftë Partia Komuniste" (cituar nga dosja specifike kushtuar Cardinali-t, në të cilën gjenden edhe foto të vendvarrimit të tij, *AQSH*, F. 177, V. 1944, D. 33/1, fl. 3). "Emri i Terziglio Cardinali-t, duke kaluar gojë më gojë, mbërrinte dhe ngushëllonte gjithë bashkëkombasit e tij që shtrëngonin pushkën e hakmarrjes" – shkruan Alessandro Serra në *Albania 8 settembre '43 – 9 marzo 1944*, Milano: Editore Longanesi & c, 1974, f. 106. Më 17 mars 1945, Cardinali u dekorua nga qeveria shqiptare me Urdhrin "Ylli Partizan", klasi i parë, i cili asokohe përbënte nderimin më të lartë të shtetit shqiptar. Më 1972, edhe Republika e Italisë i përcolli kujtimit të tij Medaljen e Artë për merita në fushën e qëndresës antifashiste.

rënë⁷⁸, batalioni italian ishte ndër pjesëmarrësit në fitoren përfundimtare. I dislokuar që prej 24 shtatorit 1944 në rrugën Elbasan-Tiranë⁷⁹, më 9 nëntor i gjithë batalioni ia lëshoi pozicionin njësiteve shqiptare dhe iu drejtua Tiranës. Më 17 nëntor, pas disa ditësh betejë rraskapitëse lagje më lagje ndaj trupave që mbanin sheshin “Skënderbej”, batalioni zhvilloi edhe luftimet përfundimtare, duke shtyrë gjermanët e mbetur të largoheshin nga kryeqyteti përmes rrugës Tiranë-Shkodër.⁸⁰ Në fund të krenitimeve, në të cilat batalioni mori pjesë solemnisht, pjesëtarë të tij vazhduan luftën deri në çlirimin e plotë të territoreve shqiptare në fund të nëntorit, dhe më pas në Mal të Zi dhe Kosovë.⁸¹

Në përfundim, për qëllime organizimi të lidhura më së shumti me procesin e koklavitur të riatdhesimit, batalioni "Gramsci" u zgjerua në brigadë, për t'u shndërruar më pas në Divizionin "Antonio Gramsci", të cilit iu bashkuan të gjithë partizanët italianë të pranishëm në njëzet e pesë brigadat shqiptare, me një përbërje tërësore prej 1 800 trupash, të ndarë në dy brigada: “Cardinali” dhe “Pignatari”.⁸² Në këtë mënyrë, falë përvojës luftarake dhe miratimit vendimtar të autoriteteve shqiptare, "Gramsci" përvetësoi tërë trashëgiminë e veprimtarisë antinaziste të italianëve në Shqipëri⁸³, duke u bërë pjesë integrale e një lëvizjeje çlirimtare. "Populli shqiptar, mirënjohës për kontributin e vlefshëm të

⁷⁸ *Il Battaglione “Gramsci” in Albania: la vicenda di Alfredo...*, f. 50; Të tjera burime flasin për një numër edhe më të lartë të humburish. A. Fiorio, “Resistere in Albania...”, f. 69.

⁷⁹ *AQSH/APP*, F. 177, V. 1944, D. 2, fl. 12/1, pa një datë të saktë, por vetëm “1943-1944”; Mario Fantacci, “Così partecipammo, unici stranieri, alla liberazione di Tirana”, në *Patria indipendente*, (XXXIII), Roma: 4 novembre 1984, nr. 17-18.

⁸⁰ Lypet të përmendet gjithashtu kontributi i italianëve që qëndronin ilegalisht në Tiranë, shumë prej të cilëve ishin ish-pjesëtarë të CMTM-së. Francesco Bonasera, *Testimonianze e documenti sulle vicende dell’Albania 1943-1944*, Edizioni Fra. Bo., “La Truganina”, Jesi (Ancona), s.d., Archivio COREMITE, doc. I/1935. Gjurma e fundit e aksioneve antiitaliane të kryera nga gjermanët, teksa niseshin në drejtim të Shkodrës, raportohet të ketë qenë pushkatimi i 45 robërve. Shih: Arturo Foschi, “La liberazione di Tirana”, in *Albania oggi*, nr. 5, settembre-ottobre 1970, f. 34, që citohet edhe në *Liri Popullit. Partigiani italiani in Albania ...*, f. 111-116.

⁸¹ Andrea Sacca, “Partecipazione italiana ai reparti partigiani albanesi nella zona di Mokra-Opari e attività svolta dopo la liberazione dell’Albania”, in *Lotta armata e resistenza delle Forze Armate italiane all’estero*, Biagio Dradi Maraldi, Romano Pieri (a cura di), Milano: Franco Angelo, 1990, f. 214-222.

⁸² *AQSH*, F. 177, V. 1944, D. 2, fl. 13.

⁸³ Massimo Coltrinari, *Albania Quarantatré – L’avviamento dei Militari Italiani ai campi di Concentramento*, Roma: Edizioni A.N.R.P., 1995, *passim*

gjakut dhe sakrificave të partizanëve italianë, pas çlirimit konsideroi të gjithë bashkatdhetarët tanë qytetarë të lirë me të njëjtat të drejta dhe të njëjtat detyra si shtetasit shqiptarë", lexohet në një raport të batalionit.⁸⁴ Këtyre fjalëve u bëri jehonë komunisti Mario Palermo, nënsekretar (figurë deri diku analoge me zëvendësministrin) italian i Mbrojtjes, i cili mbërriti në Tiranë në mars të vitit 1945 në krye të një operacioni riatdhësimi të të gjithë italianëve të pranishëm (veç atyre që ende s'u dihej fati) në Shqipëri.⁸⁵

Po në ato muaj të parë të 1945-s, vendimtare u tregua qeveria shqiptare e Hoxhës në lidhje me konfliktin verbal që shpërtheu mes gramshianëve besnikë si Brunetti dhe autoritetit më të lartë përfaqësues të ushtrisë italiane në Shqipëri, gjeneralit Piccini. Në janar, komisar politik i "Gramsci"-t akuzoi Piccini-n dhe oficerë të tjerë të ish-CMTM-së se ishin përpjekur të merrnin komandën e divizionit, për ta shndërruar atë në divizionin "Garibaldi" dhe për ta riatdhësuar si njësi luftarake në kuadër të ushtrisë italiane. Oponenca që Brunetti i dërgon Shehut, pikërisht në lidhje me këtë përplasje, daton 3 shkurt 1945.⁸⁶

"Nëse në radhët e njësisë së re që do të duhet të mbledhë të gjithë partizanët italianë, është e nevojshme që të kemi shokë që kanë qenë oficerë të ish-ushtrisë italiane, ne duam që këta oficerë të vijnë vërtet nga njësitet luftarake. Vetëm këta (pak) do të jenë në gjendje të gëzojnë besimin dhe vlerësimin e shokëve të tyre, ndërsa duke ua dorëzuar atyre oficerëve që kanë qenë në male (*të Komandës Ushtarake të Trupave në Mal – shënimi im E.Q.*), por vetëm në komanda, ose kanë qenë të strehuar ose duke punuar ose në pension, në pritje të çlirimit të Shqipërisë, do të kishte pakënaqësi të fortë midis të gjithë shokëve partizanë. Me ç'kuptojmë, sipas thashethemeve, oficerët që do të ishin pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të emëruar nga Gjenerali Piccini do t'i

⁸⁴ *AQSH/APP*, F. 177, V. 1944, D. 2, fl. 14.

⁸⁵ "Ushtarët italianë që kanë luftuar në krah të partizanëve trima shqiptarë, kundër armikut të përbashkët, i kanë zbardhur faqen Italisë në tokë shqiptare" – shkruhet në një kronikë të shtypit të kohës, [pa datë] 1945. *AQSH*, F. 177, V. 1945, D. 5, fl. 8.

⁸⁶ Në përmbledhjen e letrës, një dokument anonim i pranishëm si faqe e parë në të njëjtën dosje, përmendet "vullneti i padiskutueshëm (nga ana e gramshianëve) për të mos mbathur simbolet e ushtrisë italiane"; mbase akti i fundit i asaj metamorfoze ideologjike që komunistët shqiptarë kishin ndërsyer mbi partizanët italianë që në aktin e përfshirjes së tyre në njësitet partizane. E gjithë dosja gjendet në *AQSH*, F. 177, V. 1945, D. 8.

përkisnin kategorisë së fundit. Të gjendesh nën urdhrat e oficerëve të tillë tingëllon fyese për partizanët e vërtetë luftarakë që kanë nderuar atdheun me punën e tyre, ndërsa nëse do të kishin ndjekur shembullin e oficerëve të lartpërmendur ata do ta kishin çnderuar atë.”⁸⁷

Përgjigjja e Shehut⁸⁸, pas luftimeve të emëruar shef i Shtabit të Përgjithshëm, nuk vonoi të vinte. "Unë ju siguroj, - shkruante ai më 12 shkurt, - se nga ana ime do të bëj gjithçka mundem që të mos lejoj Piccini-n me shokë që të shkelin gjakun e Cardinali-t dhe shokëve të rënë"⁸⁹, duke pohuar vendimin e autoriteteve komuniste për të përfshirë divizionin "Gramsci" në strukturat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, bërthama zanafillore e Forcave të Armatosura të ardhshme shqiptare. Ishte gjesti i fundit, me vlerë të qartë simbolike, para përmbylljes së procesit të riadhesimit të të gjitha trupave gramshiane, më 23 maj 1945.⁹⁰

Mbërritja në Itali do t'i jepte të drejtë, së paku pjesërisht, parandjenjave të Brunetti-t. Pasi, të pamirëpritura nga asnjë autoritet i çfarëdollojshëm ushtarak apo civil, gramshianëve do t'u kërkohej që të dorëzonin armët e për njëfarë kohe do të mbaheshin në izolim, të shpërndarë në disa kampe, zyrtarisht për arsye të kontrollit mjekësor që nevojitej për repartet e ardhura nga jashtë. Të lënë plotësisht në hije, pasuesit e batalionit të vetëm komunist italian që veproi në Shqipëri, nuk do të merrnin ndonjë vlerësim, e as do të përfshiheshin në ushtrinë italiane, tashmë që Lufta II Botërore kishte përfunduar. Mbase, siç aludon edhe historiania Fiorio, kjo erdhi për shkak të damkës politike - atë të të genit i përbërë nga komunistë – që divizioni "Gramsci" mbante mbi

⁸⁷ *Po aty*, fl. 2-3.

⁸⁸ Në adresë të të cilit, me ç'rezulton, nuk munguan kurrë lëvdatat nga ana e italianëve, siç duket edhe nga dokumente në të cilat ai cilësohet "mik i madh dhe mbrojtës i luftëtarëve partizanë italianë" (*AQSH/APP*, F. 177, V. 1944, D. 2, fl. 14, pa një datë të përcaktuar, përveçse "1943-1944").

⁸⁹ *AQSH/APP*, F. 177, V. 1945, D. 8, fl. 4.

⁹⁰ Përgjatë gjithë pranverës së atij viti, një e përjavshme në italisht u shtyp në Tiranë, me titull "Unione", e cila u botua deri në ditën e riadhesimit të anëtarëve të divizionit. Kopjet e gazetës të pranishme në fondet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit tregojnë natyrën e saj përgjithësisht informuese, me lajme nga fronti evropian dhe deklarata të miqësisë reciproke midis Shqipërisë dhe Italisë. Kopja e fundit u botua më 20 maj. *AQSH*, F. 177, V. 1945, D. 4, Dokument me datë të përgjithshme "mars-maj 1945".

vete⁹¹, në një kohë kur komunistët italianë dhe sektorët pranë monarkisë (siç dhe vetë forcat e armatosura) kishin nisur fërkimet e para. Si rrjedhojë, dinamikat e para të Luftës së Ftohtë nuk do të vononin të shfaqeshin në vendin e Apenineve.

S u m m a r y

A LÉGION ÉTRANGÈRE AMONG ALBANIANS: THE HISTORY OF THE BATTALION “ANTONIO GRAMSCI” (1943-1944)

The aim of the publication is to explore the strategies the Albanian communist-led partisans deployed to convert to Communism a group of Italian militaries that joined the Antifascist resistance after Italy's capitulation in September 1943. This tiny group, formed initially by less than a hundred non-commissioned officers, was called after the name of the Italian communist leader of Albanian roots Antonio Gramsci. The transition of these Italian militaries from Fascism to Communism sheds light on the way these secular religions operated, the way they were understood by both Albanians and Italians, and, depending on the degree of internalization, the sense of mission they equipped different subjects. It is thus intended, in addition to the textual ordering of the facts gathered through the archival documentation and dispersed memories, to provide a broader explanatory framework of the developments and circumstantial political nodes - and afterwards their use in both ideological and technical-military purposes - that engaged these men in a warfare guerrilla amid a population that hardly could sympathize with them from the beginning. Furthermore, microhistorical lenses have been used to analyse the development of the Italian-Albanian relations centred in this group of militaries, which was included as a special unit within the first brigade of the Albanian National Liberation Front.

⁹¹ A. Fiorio, “Resistere in Albania...”, f. 73-74.